



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 13.7.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Emilija Rexhepi, Shaip Muja.

Munguan: Haxhi Shala, Sërgjan Popoviç dhe Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë, sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.6.2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për performancën energjetike në ndërtesa;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje, u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.6.2016

Procesverbali i datës 28.6.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për performancën energjetike në ndërtesa

Kryesuesja, për këtë pikë të rendit të ditës, sugjeroi dërgimin e projektligjit në leximin e parë, ndërsa të pranishmit Murat Hoxha, Shaip Muja, Adem Salihaj u pajtuan, ngase projektligji në fjalë përmban dispozita të bazuara në rregullat e BE-së për kodin e ndërtimit të ndërtesave.

Komisioni vendosi që ky projektligj të dërgohet në leximin e parë, në mbledhjen plenare të radhës.

4. Të ndryshme

Kryesuesja, në këtë pikë, hapi çështjet si vijon:

- Konkursi rishpallet për zëvendës drejtor në ARRU dhe për vendin e kryesuesit të komisionit shqyrtues;
- Qeverisë t'i kërkohet përgjigje rreth rekomandimeve të këtij komisioni, sa janë zbatuar ato me rastin e monitorimit të Ligjit për inspektoratin bujqësor;
- Kryesisë së Kuvendit t'i përsëritet kërkesa për mos anashkalim të këtij komisioni, me rastin e shqyrtimit të demarkacionit me Malin e Zi, pasi të arrijë lënda nga Qeveria (diskutuan: Shaip Muja, Adem Salihaj, Emilija Rexhepi);
- Kërkohet nga Qeveria të hartojë ligjin me përmbajtje të re ose të plotësohet ligji ekzistues për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Arsyetimin në plenare do ta paraqesë, nëse ka nevojë, z. Murat Hoxha.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti: stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje